






Europa:

Udhërrëfyes për mësuesit



Simbolet në kutitë tregojnë:

-  Informacion
-  Zgjidhje
-  Rekomandime

Ky udhërrëfyes për mësuesit dhe broshura "Europa: Përse bëhet fjalë në përgjithësi?" në gjuhën shqipe dhe angleze gjenden në internet në:

http://europa.eu/teachers-corner/index_en.htm

<http://bookshop.europa.eu>

<http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>

<http://integrimi.gov.al/>

Komisioni European
Drejtoria e Përgjithëshme për Komunikimin
Publikimet
1049 Bruksel
BELGJIKË

Dorëshkrimi u përfundua në maj 2013

Kopja: Eckart D. Stratenschulte, European Academy, Berlin

Botimi 'Europa, udhërrëfyes për mësuesit' në revistën për të rinjtë është botuar fillimisht në Gjermani nga 'aktion europa' (Qeveria Federale, Parlamenti European, Komisioni European). Ai është ndryshuar dhe përditësuar nga Drejtoria e Përgjithëshme për Komunikimin e Komisionit European. Faqosja origjinale është përgatitur nga Zeitbild Verlagund Agentur für Kommunikation, Berlin/Meta Design AG, Berlin. Seritë e fotografive të të rinjve Alice, Jello, Patricia, Motian dhe Hanette janë përgatitur nga Zeitbild.

Botimi në gjuhën shqipe u përgatit në kuadër të projektit të asistencës teknike SMEI 3 «Mbështetje për Procesin e Integritimit European – faza III», financuar nga Bashkimi European (IPA 2010).

Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit European, 2013

ISBN 978-92-79-29404-4

doi:10.2775/15228

2013 — 12 fq. — 21 × 29.7 cm

© Bashkimi European, 2013

Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive individuale duhet të kërkohet leja e atyre që kanë të drejtën e autorit.

NA-32-13-192-EN-C

1. Europa në jetën e përditëshme

Qëllimi i këtij kapitulli është që të njohë studentët me karakteristikat e Bashkimit European dhe ndikimin e tyre në jetën e përditëshme. Qëllimi është që të nxitet kureshtja për BE-në.

! Sa larg është Brukseli? f.5

Komisioni European bën dy sondazhe opinioni në vit për të mësuar se ç'mendojnë qytetarët e BE-së për çështjet Europiane. Këto mund të gjenden në: http://ec.europa.eu/public_opinion/index_en.htm

Faqja kryesore është në anglisht dhe frëngjisht, por shumica e raporteve mund të gjenden në gjuhë të ndryshme të BE-së.

Si punon Bashkimi European?

Në Europë, në përgjithësi, 52% e qytetarëve të BE-së (që përbën më shumë se gjysmën) kërkojnë të dinë si punon BE-ja.

Sidoqoftë, sondazhi i rregullt i Bashkimit European për opinionin publik – ‘Eurobarometer’ – përmban disa pyetje që synojnë të mësohet sa dinë realisht ata që pyeten.

52% e dinë se anëtarët e Parlamentit European zgjidhen nga qytetarët. 16% mendojnë se Zvicra është në BE, 13% pranojnë se nuk e dinë.

Burimi: Eurobarometer No 77 (spring 2012) (http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb77/eb77_en.htm).

?/* Europa — një lojë e shkurtër f.5

- Bashkimi European ka **28** shtete anëtare, pas pranimit të Kroacisë në Korrik 2013.
- Anëtarët e Parlamentit European zgjidhen **drejtpërsëdrejti nga qytetarët në zgjedhjet e përgjithëshme me votim të fshehtë**.
- **Tetëmbëdhjetë** vende të BE-së përdorin Euron si monedhë të tyre.
- Buxheti total i BE-sëpërfaqëson **më pak se 1%** të prodhimit të brendshëm bruto (GDP) të shteteve anëtarë të BE-së. GDP është vlera totale e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë 1 viti.
Shih: <http://ec.europa.eu/budget/index.cfm>
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European ka selinë e vet në **Luksemburg; Brukseli** strehon selinë e Komisionit European; Parlamenti European është vendosur në **Strasburg** (por zhvillon seanca të shkurtra plenare edhe në Bruksel) dhe në kryeqytetin portugez **Lisbonë**, ku është nënshkruar traktati aktual.

Kur analizoni përgjigjet e studentëve tuaj, mbani parasysh në ç'masë janë ata të painformuar ose të panjohur me zhvillimet e fundit.

* Ç'lidhe ka BE-ja me ne? f.6

Pas këtij ushtrimi studentëve duhet t'u jepet mundësia të bëjnë komentet e tyre dhe të diskutojnë mbi përvojën e tyre.

? Arsimimi dhe studimi në vendet e tjera të BE-së f.8

Studentët tuaj pa dyshim do të japin arësye të ndryshme pro dhe kundër vajtjes jashtë për të studiuar në një vend tjetër. Argumentet për të studiuar jashtë mund të përfshijnë marrjen e përvojave të reja, njohjen me njerëz të tjerë, zbulimin se si i trajtojnë ata disa çështje, përmirësimin e aftësive për gjuhët e huaja, zgjerimin e horizontit të tyre, etj. Arësytet për të mos studiuar jashtë përfshijnë: ndarja nga miqtë dhe familja, vështirësitë e studimit në një gjuhë të huaj, (dhe për këtë arsye marrja e rezultateve më të dobëta) malli për shtëpinë, problem të marrëdhënieve, shpenzimet e udhëtimit për të vizituar miqtë dhe familjen, etj.

? Simbolet Europiane f.9

1. **Pashaporta e Bashkimit European**—identifikon mbajtësin si qytetar të Bashkimit European.

2. **Patenta e BE-së për makinën** është e vlefshme në gjithë Europën. Që nga viti 2012, rreth 110 lloje të ndryshme patentash brenda BE-së janë zëvendësuar me një patentë uniforme Europiane, sipas ligjit European. Që atëherë të gjitha patentat e lëshuara kanë qenë patenta të BE-së. Patentat e vjetra mbeten të vlefshme edhe për 26 vjet dhe pastaj duhet të merren patenta të reja.

3. **Etiketa e BE-së për energjinë** vlerëson ujin dhe energjinë që konsumon një pajisje duke e llogaritur nga A (energji më e efektshme) në G (më pak e efektshme).

4. **Etiketa CE** ka të bëjë me sigurinë e mallit sipas legjislacionit të BE-së për disa mallra. Ajo nuk është etiketë për cilësinë. Qëllimi kryesor i kësaj etikete është të sigurojë që mallrat që u shiten konsumatorëve më kërkues brenda Zonës Ekonomike Europiane (EEA) janë të padëmshme. EEA përfshin vendet e BE-së dhe EFTAs (Marrëveshja Europiane e Tregëtisë së Lirë) (por jo Zvicrën). Etiketa CE shpesh konsiderohet si një ‘pashaportë’ për tregun ndërkombëtar.

5. **Logoja e re e BE-së** që ka qenë e detyrueshme që nga viti 2010 për mallrat organike garanton, sipas Komisionit European, se:

- të paktën 95% e përbërësve të prodhimeve me origjinë bujqësore janë prodhuar organikisht,
- prodhimi u përmbahet rregullave të skemës zyrtare të inspektimit,
- prodhimi ka ardhur direkt nga prodhuesi ose përgatitësi i pakos së vulosur,
- prodhimi ka emrin e prodhuesit, të përgatitësit ose shitësit dhe emrin ose kodin e organit të inspektimit.

Burimi: http://ec.europa.eu/agriculture/organic/consumer-confidence/logo-labelling_en

2. Bashkimi European — çfarë do të thotë kjo saktësisht?

Qëllimi i këtij kapitulli është të prezantojë shtetet anëtarë të Bashkimit European dhe të theksojë se BE-ja dhe Europa nuk janë e njëjta gjë. Objektivi i parë është të njihen studentët me BE-në. Është e nevojshme të theksohet arsyeja fillestare për krijimin e BE-së, për sigurimin e paqes midis shteteve anëtarë. Rekomandohet që ju të vini në dukje se varianti i parë i BE-së, Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) u krijua menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Traktati i ECSC u nënshkrua më 1951 dhe hyri në fuqi më 1952. Në atë kohë, dyshimi i ndërsjellë midis palëve ishte ende i konsiderueshëm. Traktatet për krijimin e Komunitetin Ekonomik European (EEC) dhe Komunitetin European të Energjisë Atomike (Euroatom) u nënshkruan më 1957 dhe hynë në fuqi më 1958. Ato njihen si Traktatet e Romës.

? Shtetet anëtarë të Bashkimit European — cili është anëtar? f. 11

Anëtarët e BE-së

Vendi	Viti i pranimit	Popullsia (2012)	Kryeqyteti
Belgjika	Anëtar themelues 1952/1958	11.1 milion	Bruksel
Franca	Anëtar themelues 1952/1958	65.3 milion	Paris
Gjermania	Anëtar themelues 1952/1958	81.8 milion	Berlin
Italia	Anëtar themelues 1952/1958	60.8 milion	Romë
Luksemburgu	Anëtar themelues 1952/1958	0.5 milion	Luksemburg
Hollanda	Anëtar themelues 1952/1958	16.7 milion	Amsterdam(*)
Danimarka	1973	5.5 milion	Kopenhagen
Irlanda	1973	4.5 milion	Dublin
Mbretëria e Bashkuar	1973	62.9 milion	Londër
Greqia	1981	11.3 milion	Athinë
Portugalia	1986	10.5 milion	Lisbonë
Spanja	1986	46.1 milion	Madrid
Austria	1995	8.4 milion	Vienë
Finlanda	1995	5.4 milion	Helsinki
Suedia	1995	9.4 milion	Stokholm
Qiproja	2004	0.8 milion	Nikosia
Republika Çeke	2004	10.5 milion	Pragë
Estonia	2004	1.3 milion	Talin
Hungaria	2004	9.9 milion	Budapest
Letonia	2004	2.0 milion	Riga
Lituania	2004	3.0 milion	Vilnius
Malta	2004	0.4 milion	Valetta
Polonia	2004	38.5 milion	Varshavë
Slovakia	2004	5.4 milion	Bratislavë
Slovenia	2004	2.0 milion	Ljubljana
Bullgaria	2007	7.3 milion	Sofia
Rumania	2007	21.3 milion	Bukuresht
Kroacia	2013	4.4 milion	Zagreb

(*) Kryeqyteti i Hollandës është Amsterdami, megjithëse selia e qeverisë dhe e familjes mbretërore është Haga.

Burimi: <http://epp.eurostat.ec.europa.eu>

Fakte dhe shifra të tjerfa mund të gjenden në të gjitha gjuhët zyrtare në:

http://europa.eu/abc/euslides/index_en.htm

Studentët mund të ngjyrosin ose të shënojnë në hartë sa më poshtë: Belgjikë, Francë, Gjermani, Itali, Luksemburg dhe Hollandë me të kuqe; Danimarkë, Irlandë dhe Mbretëria e Bashkuar me kafe; Greqia me rozë; Portugal dhe Spanja me të verdhë; Austria, Finlanda dhe Suedia në blu të errët; Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Slovakia dhe Slovenia në jeshile; Bullgaria dhe Rumania në blu të çelët; Kroacia në vjollcë.

* Faqet e fakteve për vendin f. 11

Shumica e studentëve do të kenë patur përvojën e tyre për shtetet e tjerë anëtare. Rekomandojmë që ju t'i ftoni ata për t'i ndarë këto përvoja (Çfarë dini tjetër për vendet e Europës?) dhe për t'i strukturuar ato. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të përpilohen "faqet e

fakteve" të duhura të paktën për disa shtete anëtarë. Kjo gjithashtu mund të bëhet në çifte ose në grupe. Kështu studentët mund të ndjehen se mund të kontribuojnë në diskutim me përvojën e tyre.

1. Valeta, Malta. Sipas qeverisë së Maltës ajo ka 6 966 banorë.
2. Temperaturën mesatare më të ulët e ka Vilnius, në Lituani, me -11°C në janar. Temperatura më e lartë në verë është në Nikosia, me një temperaturë maksimale mesatarisht prej 37°C .
3. Përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është aq e drejtpërdrejtë sa mund ta imagjinoni ju. Ka dy përgjigje të sakta në varësi të përkufizimit për Europën. Nëse Kaukazi konsiderohet si pjesë e Europës, përgjigjia është Mali Elbrus në Kaukazin verior rus (5 642m). Përndryshe, përgjigjia është Mont Blanc (4 810m) në Alpet, në kufirin midis Francës dhe Italisë.
4. BE-ja kufizohet me Detin e Veriut, Balltikun, Mesdheun, Atlantikun dhe Detin e Zi.
5. BE-ja ka shtatë monarki (Belgjikën, Danimarkën, Luksemburgun, Hollandën, Spanjën, Suedinë dhe Mbretërinë e Bashkuar). Belgjika, Holanda, Spanja dhe Suedia kanë një mbret në krye të shtetit. Danimarka dhe Mbretëria e Bashkuar kanë një mbretëreshë. Kryetari i shtetit në Luksemburg është "Duka i Madh i Luksemburgut"
6. Tre: Hollandez, Francez dhe Gjerman
7. Gjermania.
8. Franca, në $544\,000\text{ km}^2$.

9. Kryeqyteti më lindor është Nikosia, në $35^{\circ}10'N$, $33^{\circ}21'E$.

Pyetje e veçantë për ekspertët:

10. Numri i yjeve nuk ka të bëjë fare me numrin e shteteve anëtare. Janë 12 yje sepse numri 12 tradicionalisht është simboli i diçkaje të plotë, të përkryer dhe në unitet. Prandaj flamuri mbetet i njëjtë, edhe kur të bashkohen shtete të tjerë.

Burimi: http://europa.eu/abc/symbols/emblem/index_en.htm

? A e flisni gjuhën Europiane

f. 12

24 gjuhët zyrtare të BE-së janë: bullgarishtja, kroatishtja, çekishtja, danishtja, hollandishtja, anglishtja, estonishtja, finlandishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, greqishtja, hungarishtja, irlandishtja, italishtja, letonishtja, lituanishtja, maltishtja, polonishtja, portugalishtja, rumanishtja, sllovakishtja, sllovenishtja, spanjishtja dhe suedishtja.

? Historia e fotografive të BE-së

f. 15

Fajta majtas, nga kreu në fund: 6 – 1 – 3

Fajta djathtas, nga kreu në fund: 2 – 5 – 4 – 7


3. Si punon Bashkimi European?

Qëllimi i këtij kapitulli është të paraqesë institucionet e Bashkimit European dhe të japë një ide si funksionon BE-ja.

? Kush bën çfarë në BE?

f. 19

Përshkrimi	Këshilli European	Këshilli i Bashkimit European	Parlamenti European	Komisioni European	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European	Banka Qëndrore e Bashkimit European	Këshilli Revizorëve të BE-së
Bën propozime për rregullat e BE-së	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përbëhet nga një përfaqësues për çdo Shtet Anëtar	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Vetëm shtetet anëtarë me Euro	<input checked="" type="checkbox"/>
Përcakton normat bazë të interesave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Monitoron shpenzimet e BE-së	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Zgjidhet nga popullsia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pranon ligjet e BE-së (rregullat/ direktiva)	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Emëron Presidentin e Komisionit	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Administron BE-në	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfaqëson interesat e qytetarëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfaqëson interesat e shteteve anëtarë dhe qeverive të tyre	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Rregullon interpretimin e legjislacionit European	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përcakton direktivat dhe prioritetet e përgjithshme politike	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



?/* Iniciativat e qytetarëve Europeanë: shqetësimet për programin e Komisionit

Qëkurse Traktati i Lisbonës hyri në fuqi, qytetarët kanë pasur të drejtën të bashkohen dhe të detyrojnë Komisionin të trajtojë një çështje të caktuar. Iniciativa qytetare duhet të mbështetet të paktën nga një milion qytetarë të BE-së, që janë 0.2 % e popullsisë dhe ata duhet të jenë qytetarë të paktën të shtatë nga 28 shtetet anëtare. Në secilin nga këta shtete anëtarë kërkohet një minimum firmash. Prandaj nuk ka mundësi të ketë 999 994 firma nga një shtet anëtar dhe një firmë nga të gjashtë shtetet e tjerë anëtarë.

Duhet të mbahet parasysh që iniciativa e qytetarëve Europeanë të ketë të bëjë me çështje që janë në kompetencat e Bashkimit European dhe që nuk bien në kundërshtim me vlerat themelore të BE-së. Për shembull, një iniciativë qytetare që përfshin dënimin me vdekje është e papranueshme sepse ajo bie në kundërshtim me Kartën e të Drejtave Themelore. Një nismë qytetare mbi disa aspekte të organizimit të shkollës do të ishte gjithashtu e papranueshme sepse arsimi është çështje e çdo shteti anëtar. Një iniciativë qytetare nuk mund të bëjë

ligje drejtpërsëdrejti. Ajo nuk është referendum. Megjithatë, ajo mund të nxisë ose të ndikojë në marrjen e disa vendimeve. Kështu, ajo është më tepër një mënyrë e formulimit të vendimeve sesa e marrjes së tyre.

Nismëtarët kanë 1 vit për të mbledhur një milion firma (që mund të jenë elektronike). Aktualisht ka disa nisma qytetare në proces. Një listë e përditësuar në të gjitha gjuhët zyrtare mund të gjendet në: <http://ec.Europa.citizens-initiative/public/welcome>

Studentët tuaj mund të bënin sugjerime për çfarë do të donin të përmirësohej dhe çfarë është e rëndësishme për ta. Kjo është gjithashtu një mënyrë e mirë për të mësuar çfarë kompetencash ka BE-ja (si edhe për ta ditur se BE-ja nuk është institucion përgjegjës për çdo gjë).







?/* Çfarë është një peticion?

Një peticion (nga latinishtja petitio 'kërkesë'; 'plea') është një kërkesë ose ankesë drejtuar një autoriteti kompetent ose një organi përfaqësues. Zakonisht është një kërkesë e qytetarëve drejtuar parlamentit për të ndryshuar ose përshtatur ligje të caktuara, etj. Mundësia për të formuluar një peticion përgjithësisht është njohur si një normë e të drejtave demokratike. Peticionet drejtuar parlamentit i dërgohen komitetit përkatës të peticioneve, i cili i shqyrton dhe jep përgjigje.

Parlamenti European ka krijuar një Komitet të Peticioneve që merret me peticionet e qytetarëve. Në rast se jetoni në një shtet anëtar të BE- së dhe mendoni se të drejtat tuaja janë shkelur dhe doni të paraqitni një ankesë individuale që Parlamenti European të mbajë një qëndrim për një çështje me interes publik, ju mund t'i drejtoheni (vetë ose me të tjerë) Komitetit të Peticioneve me shkrim ose Parlamentit European në internet.

Shumica e peticioneve që ka shqyrtuar Komiteti kanë pasur të bëjnë me sigurinë sociale, mbrojtjen e mjedisit, harmonizimin e taksave, lëvizjen e lire dhe njohjen e kualifikimit.

Parlamentet kombëtare zakonisht kanë gjithashtu komitetet peticioni ose ombudsmani, të cilin qytetarët mund t'i drejtohen me ankesa. Ju mund të gjeni më shumë informacion në faqen elektronike të Ombudsmanit European, që dokumenton gjithashtu rrjetin European të Ombudsmanit: <http://www.ombudsman.Europa.BE/home.faces>

Grupet politike në Parlamentin Europian	Sa anëtarë ka ky grup?
 EPP — Grupi i Partisë Popullore Europiane (Kristian Demokratë)	275
 S & D — Grupi i Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve në Parlamentin Europian	196
 ALDE — Grupi i Aleancës të Liberalëve dhe Demokratëve të Europës	85
 GREENS/EFA — Grupi i të Blerëve / Aleanca e Lirë Europiane	58
 ECR — Grupi Europian i Konservatorëve dhe Reformistëve	55
 EFD — Grupi Europa e Lirisë dhe Demokracisë	35
 GUE/NGL — Grupi Konfederal i të Majtës Europiane të Bashkuar/e Majta e Blerët Nordike	34
NI Të paadruarit	28

NB: Këto numra ndonjëherë luhaten sepse njerëzit hyjnë dhe dalin

Listën e të gjithë anëtarëve të Parlamentit Europian dhe partive të tyre respektive mund ta gjeni në: <http://www.europarl.europa.eu/meps/en/map.html>

* Ftoni Anëtarin e PE për vizitë

f. 23

Anëtarëve të Parlamentit Europian u pëlqen shumë t'u flasin të rinjve.

Të gjithë anëtarët e PE kanë një zyrë në Bruksel dhe një në zonën e tyre, kështu që është e lehtë t'i kapni ata. Për hollësi shihni në: <http://www.europarl.eu>

? Europa — një lojë e shkurtër

f. 23

Kush është Presidenti aktual i Parlamentit Europian? Dhe kush janë zotërinjtë e tjerë në fotografi?

1. Socialdemokrati Gjerman **Martin Schulz** është Presidenti Parlamentit Europian.
2. **Robert Schuman** ish ministri i jashtëm francez nga viti 1948 deri 1952. Schumani, i cili vdiq më 1963, ishte një nga themeluesit e Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC).
3. **José Manuel Barroso**, nga Portugalia, është Presidenti Komisionit Europian.
4. Belgu **Herman Van Rompuy** është Presidenti Këshillit Europian

4. Çfarë bën BE-ja saktësisht?

Qëllimi i këtij kapitulli është të paraqesë fushat më të rëndësishme të politikës të Bashkimit Europian.

? Europa — një lojë e shkurtër

f. 26

Përgjigjia e saktë është 9 maj 1950. Kjo ishte dita kur Ministri i Jashtëm Francez Robert Schuman propozoi një Komunitet Europian për sigurimin e një paqeje të qëndrueshme në Europë. Kjo iniciativë çoi në krijimin e Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC), që filloi të veprojë më 1952. Ky ishte i pari nga tre komunitetet Europiane që u krijuan më 1958 në bazë të Traktateve të Romës të vitit 1957, që u pasua nga Komuniteti Ekonomik Europian (EEC) dhe Komuniteti Europian i Energjisë Atomike (Euroatom). Traktati i Maastrichtit i shkriu këto komunitete për të krijuar Bashkimin Europian (BE). Politikisht, 9 Maji 1950 shënon lindjen e Bashkimit Europian, pikërisht pas 5 vjetësh pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore.

Më shumë informacion do të gjeni në: http://europa.eu/about-eu/eu-history/founding-fathers/index_en.htm

! Ushtrim mbi Eurogrupin

f. 28

Ky ushtrim ka të bëjë vërtetë me çështje delikate. Të 18 shtetet anëtare që aktualisht përdorin Euron marrin shumë vendime në Eurogrup, që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e një monedhe të vetme, por që prekin edhe vendet e tjera të BE-së. Prandaj është e rëndësishme të llogaritet mirë ç'vendime duhet të merren dhe në ç'nivel. Zona Euro, që ka Presidentin e vet — Ministrin Hollandez të Financave Jeroen Dijsselbloem dhe grupin e vet të punës — përbëhet nga ministrat e financës të 18 shteteve të zonës Euro dhe koordinon politikën ekonomike të këtyre shteteve për të krijuar maksimumin e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë brenda zonës së Euros.

Eurogrupi përpiket të sigurojë konsensus me shtetet e tjerë anëtarë, veçanërisht me të ashtuquajturit 'paraprakë', që do të kalojnë në monedhën e përbashkët në vitet që vijnë. Një shembull për këtë është Euro Plus Pact (pakti Euro plus), në të cilin shtetet pjesëmarrës marrin përsipër të ndërmarrin masa për të përmirësuar konkurrencëshmërinë. Emri i paktit tregon se ai përfshin shtete të zonës Euro plus, vende të tjera të BE-së (Bullgaria, Danimarka, Lituania, Polonia dhe Rumania).

Më shumë informacion për Eurogrupin mund të gjendet në: <http://eurozone.europa.eu>, dhe në botimin e mëposhtëm mbi Euron që mund të jetë gjithashtu me interes:

<http://bookshop.europa.eu/en/economic-and-monetary-union-and-the-euro-pbNA7012001>

? Europa — një lojë e shkurtër f. 29

Cilat nga këto vende nuk janë në zonën e euros?

Polonia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar. Monedhat euro në fotografi janë nga vendet e mëposhtme (nga e majta në të djathtë): Austria, Sllovenia, Estonia, Greqia, Franca, Italia, Gjermania, Holanda, Irlanda, Malta, Finlanda, Sllovakia, Luksemburgu, Portugalia, Qiproja, Spanja dhe Belgjika.

* Masat për mbrojtjen e klimës — Mendoni se kjo politikë është e drejtë? f. 31

Mbrojtja e klimës është pa dyshim një çështje e sotme e rëndësishme, kështu që tabela që përmban mendime të ndryshme për problemin ka një material ideal për të bërë diskutime me studentët.

Ushtrimi që sugjerohet: Diskutoni në grupe tre qëllimet kryesore për mbrojtjen e klimës të miratuara nga Këshilli Europian në Mars 2007. Gjeni rrugët e veçanta për arritjen e këtyre qëllimeve. Mendoni gjithashtu si mund të kontribuojë secili personalisht për këtë. Mendoni gjithashtu për shkaqet që pengojnë arritjen e këtyre qëllimeve. Diskutoni rezultatet në klasë.

! Karta e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore f. 32

Karta e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore u hartua nga një mbledhje që përfshinte Parlamentin Europian, parlamentet kombëtare, qeveritë kombëtare dhe Komisionin Europian. Ajo u shpall në Dhjetor 2000 me rastin e Mbledhjes së Nivelit të Lartë në Nisë dhe që kur Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 2009, u përfshi në legjislacionin e BE-së. Qëllimi i mbledhjes nuk ishte 'shpikja' për një kushtetutë të re,

por më tepër të zgjerjë mbrojtjen e të drejtave themelore që tanimë ekzistonin në shtetet anëtarë, duke përfshirë kështu identitetin evropian. Për këtë arsye, Karta e të Drejtave Themelore është një përmblendje e të drejtave njerëzore dhe themelore ekzistuese në BE. Ajo është gjithashtu e rëndësishme si një dokument juridik përderisa shtrihet në të gjitha institucionet Europiane. Gjykatat kombëtare duhet gjithashtu të marrin në konsideratë Kartën e të Drejtave Themelore kur interpretojnë legjislacionin e BE-së. Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar kanë negociuar përjashtimin, por kjo ka të bëjë vetëm me shtrirjen kur mund të referohet Karta Themelore në kontekstin e seancave të gjykatave kombëtare dhe deri kur mund të shtrihen kompetencat e Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Europian në çështjet ligjore kombëtare. Republikës Çeke i është bërë gjithashtu një përjashtim i kësaj natyre.

Meqënëse Karta e të Drejtave Themelore u përpilua në vitet 1990, me fjalë të tjera më vonë se kushtetutat e shumicës së shteteve anëtare, ajo është shumë e përditësuar. P.sh. ajo përmban ndalimin e prodhimit me anën e klonimit njerëzor (neni 3(2)(df), të drejtën e mbrojtjes të të dhënave personale (neni 8(1)), dispozita të hollësishme mbi ndalimin e diskriminimit për shkak faktorësh të ndryshëm, përfshi orientimin seksual (neni 21) ose për arritjen e një standardi të lartë në mbrojtjen e konsumatorit (neni 38). Të drejtat e administrimit të mirë (neni 41) dhe shfrytëzimit të dokumenteve (neni 42) gjithashtu janë të përfshira në Kartë. 50 të drejtat themelore që përfshihen në kapitujt Dinjiteti, Liritë, Barazia, Solidariteti, të Drejtat e Qytetarëve dhe Drejtësia pasohen nga katër nene të tjera që rregullojnë zbatimin dhe shtrirjen e Kartës të të Drejtave Themelore.

Disa aspekte nuk përmenden posaçërisht, si e drejta për punë (ndonëse e drejta për t'u lejuar të angazhohesh me punë ekziston). Ka dispozita jo specifike për mbrojtjen e pakicave etnike, megjithëse këto përmenden posaçërisht në lidhje me ndalimin e diskriminimit (neni 21 i Traktatit të BE-së).

Më shumë informacion mund të gjendet si vijon:

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:12012P/TXT:EN:NOT>

*/? Pema e politikave europiane f. 33



Po të keni kohë, mbase doni t'i hidhni një sy 'Pemës të politikës Europiane'. Pse të mos u kërkonte studentëve të mbledhin artikuj të gazetave të fundit dhe të shohin nëse përmblajnë temat e përmendura në ilustrimet? Kështu pema mund të përbante më shumë çështje.

5. Europa ecën përpara — zgjerimi i Bashkimit European

Qëllimi i këtij kapitulli është t'i njohë studentët me ecurinë e zgjerimit dhe t'u tregojë se BE-ja është një komunitet i mbështetur në vlera, që u bën kërkesat përkatëse anëtarëve të rinj potencialë.

? Kush mund të bëhet anëtar? f. 35

Një vend ...	mund të hyjë në BE.	nuk mund të hyjë në BE.
... që nuk ka lirinë e shtypit	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
... që zbaton dënimin me vdekje	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
... që lejon qytetarët e vet të protestojnë kundër qeverisë	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... në të cilin parlamenti zgjidhet rregullisht	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... në të cilin presidenti drejton deri sa vdes dhe pasardhës është djali i tij	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
... në të cilin homoseksualët dhe lesbiket kanë të njëjtat të drejta si heteroseksualët	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... në të cilin ushtria përcakton politikën dhe mund të ndërhyjë në çështjet e brendshme me forcë	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
... në të cilin njerëzit konsiderohen të pafajshëm derisa faji të përcaktohet me një vendim gjykatë	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... në të cilin ka vetëm një parti dhe rrjedhimisht ajo është gjithmonë në qeveri	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
... e cila mbron pakicat, edhe kur shumica do të bëjë më shumë presion ndaj pakicave	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

! Ku janë kufijtë e Europës? f. 36

Shoqata dhe organizata të ndryshme kanë përbërje të ndryshme anëtarësh. Për shembull, Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Europë (OSBE) përfshin vende të Azisë qendrore, si Kazakistan, Kirgistani, Takhikistani, Turkmenistani dhe Uzbekistani (dhe për shkak të rëndësisë së politikës së tyre të sigurisë si anëtarë të NATO-s, edhe Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja). Në ndeshjet e kampionatit European të futbollit janë përfshirë Kazakistan dhe Izraeli.

* Ku mbaron Europa? f. 36

Menjëherë sa filloni diskutimin për këtë çështje bëhet e qartë se nuk ka ndonjë kriter objektiv për të vendosur se ku mbaron Europa. Duhet të mbahen parasysh faktorë të ndryshëm si gjeografia, historia, kultura dhe ndjenja e përkatësisë. Këshilli i Europës e përkufizon Europën si 'ato vende që duan të jenë Europiane'. Përkufizimi mund të shtrihet duke e cilësuar se Europë do të thotë 'ato vende që duan të jenë Europiane dhe pranohen nga të tjerët si Europiane'.

? Shtetet e Ballkanit Perëndimor — Cilët? Ku? f. 37

Shih hartën në të djathtë.

? Hapat drejt anëtarësimit në BE. f. 38

0. Procesi i pranimit nuk ka filluar ende.
1. Konkluzioni për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit
2. Ratifikimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit nga shtetet anëtarë dhe vendi partner.
3. Zbatimi i marrëveshjes.
4. Kërkesa për anëtarësim.
5. Përgjigjia pozitive e Komisionit European ndaj kërkesës për anëtarësim.
6. Njohja si vend kandidat.

7. Fillimi i bisedimeve për pranim.
8. Përfundimi i suksesshëm i bisedimeve për pranimin.
9. Ratifikimi i Traktatit të pranimit në të gjitha shtetet anëtare dhe në vendin partner (nga parlamentet ose me referendume).
10. Ratifikimi nga Parlamenti European.
11. Anëtarësimi.

? Në çfarë faze janë vendet e Ballkanit Perëndimor? f. 38

Kroacia: faza 11. Kroacia u bë anëtare e plotë më 1 korrik 2013.

Mali i Zi: faza 7.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: faza 6.

Serbia: faza 7. Bisedimet e pranimit kanë filluar në janar 2014.

Shqipëria: faza 5.

Bosnja dhe Hercegovina: faza 1.

Kosova nuk është njohur nga pesë shtete anëtarë të BE-së (Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) dhe nuk është përfshirë në proces. Prandaj është në fazën 0, d.m.th. ende nuk e ka filluar procesin e pranimit.

Negociatat e pranimit me Turqinë kanë vazhduar që nga viti 2005, dhe me Islandën që nga 2010.

Po të ketë kohë, studentët mund të ndaheshin në grupe dhe të pyeteshin më shumë për njërin nga vendet e Ballkanit (për

shembull për gjeografinë, historinë, ekonominë dhe politikën). Atëherë ata mund të raportonin dhe të përgjigeshin për pyetjen 'Cilat janë, sipas jush, argumentet kryesore pro ose kundër të pranimit të këtij vendi në Bashkimin European?'



Një çështje që është diskutuar gjerësisht në media, dhe që sigurisht u intereson studentëve, është mundësia që Turqia të hyjë në BE. Turqia, me të cilën ka një marrëveshje asociimi që nga viti 1963, është pranuar si kandidatë më 1999. Negociatat e pranimit, të cilat kanë qenë të diskutueshme në BE, vazhdojnë të zhvillohen që nga viti 2005.

Çdo argument në favor hidhet poshtë nga një argument kundër — dhe anasjelltas. A është popullsia e re dhe dinamike e Turqisë, që do të gëzonte lëvizjen brenda BE-së, një mundësi për të na bërë ne më konkurrentë apo një rrezik për vendet tona të punës? A do të sillte pranimi i Turqisë stabilitet në Lindjen e Mesme, për shkak të pozitës

së saj gjeografike, apo kufijtë e saj me Iranin, Irakun dhe Sirinë do të destabilizojnë BE-në? A do të përbënte popullsia muslimane e Turqisë një urë me botën islamike apo një rrezik për identitetin Europian?

Të gjitha këto çështje janë ngritur publikisht dhe mund të diskutohen në klasë. Kërkoni nga studentët të shohin në internet nëse në lajmet e fundit ka zhvillime për këtë çështje.

Informacion aktual për Turqinë lidhur me hapat për anëtarësim mund të gjendet në Progres Raportin e Komisionit Europian të tetorit 2013, këtu:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package_brochures/turkey_2013.pdf

6. Europa dhe bota në përgjithësi

Qëllimi i këtij kapitulli është të shihet Europa në kontekstin global dhe të kuptohet roli i Bashkimit Europian si një aktor ndërkombëtar.

? Kontinentet e botës

f. 41

Krahasim i përmasave, popullsisë dhe sipërfaqeve të kontinenteve.

Kontinenti	Sipërfaqja (km ²)	Përqindja e sipërfaqes së tokës	Popullsia	Renditja sipas popullsisë	GDP ⁽¹⁾ për frymë në dollarë USD	Renditja sipas GDP ⁽¹⁾
Asia (përfshirë Lindjen e Afërme)	47.8 milion	30.0 %	4 260 milion	1	2 941	5
Afrika	30.4 milion	20.3 %	1 072 milion	2	1 576	6
Amerika e Veriut	24.2 milion	16.3 %	349 milion	5	32 077	2
Amerika e Jugut ⁽²⁾	17.8 milion	12.0 %	599 milion	4	32 077	4
Europa ⁽³⁾	10.0 milion	6.7 %	740 milion	3	25 434	3
Australia/Oqeania	7.7 milion	5.2 %	37 milion	6	39 052	1

⁽¹⁾ GDP(PPP) = paritetet e fuqisë blerëse, d.m.th shifrat absolute janë marrë në përpulje me fuqinë blerëse dhe kështu janë të krahasueshme.

Të gjitha vlerat janë rrrumbullakosura.

⁽²⁾ Përfshirë Amerikën Qëndrore dhe Karaibet.

⁽³⁾ Përfshirë Turqinë, por jo Rusinë.

Burimi: Encyclopaedia Britannica online, 2012; World population data sheet, International Monetary Fund, 2012 — publikuar 23 Maj 2013.

Shifrat nuk janë aq të sakta sa duken. Përveç pasaktësive statistikore, ka ndryshime edhe në përkufizim. Qëllimi i këtij ushtrimi është më tepër të dikutojnë tendencat dhe pozicionin e Europës në to.

? Sfidat globale

f. 42

Sfidat globale	Zgjidhja e propozuar
Luftrat dhe konfliktet civile	Paqeruajtja përmes ndërhyrjes ushtarake. Mbështetja e demokracisë.
Varfëria	Falja e borxheve për vendet e pazhvilluara. Hapja e tregjeve Europiane për mallrat nga vendet në zhvillim.
Sëmundjet	Pëmirësimi i sistemeve shëndetësore në vendet më pak të zhvilluara.
Prapambetja	Ndihma e zhvillimit për Afrikën.
Mungesa e burimeve	Mbrojtja e rezervave ujore të botës.
Varësia e Europës për energji	Bashkëpunimi për energjinë përtej kufijve të Europës.
Popullsia në plajkë në Europë	Menaxhimi i imigracionit.
Terrorizmi	Dialogu me botën islamike. Lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar. Siguria e internetit.
Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë	Kontrolli ndërkombëtar i armëve dhe marrëveshjet e çarmatimit.
Krimi i organizuar	Bashkëpunimi ndërkombëtar policor.
Kërcënimi ndaj mjedisit natyror	Mbrojtja e klimës. Lufta kundër ndotjes së detrave.

Faqja majtas, nga sipër poshtë:
10 – 7 – 3 – 8 – 5 – 4 – 1 – 2 – 9 – 6
Faqja djathtas, nga sipër poshtë:
2 – 6 – 1 – 5 – 8 – 10 – 7 – 4 – 9 – 3

Një vështrim i shkurtër i politikës së zhvillimit të BE-së gjendet në:

http://europa.eu/pol/dev/index_en.htm

fitojnë bukën e tyre me punë të rastit në tregun e zi). A duhet të arrestohen ata dhe të dërgohen mbrapsht, edhe pse kanë qënë për disa kohë në Europë, apo situata e tyre duhet të rregullohet me një qëndrim të tyre të përhershëm?

Ushtrim i sugjeruar: Krijoni dy grupe, njëri në favor të riadhesimit dhe tjetri në favor të rregullimit të situatës të migrantëve ilegalë.

U jepni atyre deklaratat e mëposhtme (pro dhe kundra) dhe u kërkoni të diskutojnë duke sjellë edhe argumentet e tyre.

Një çështje tjetër e diskutueshme është ç'duhet bërë me njerëzit që shkojnë në Europë ilegalisht dhe qëndrojnë për disa vite (shpesh e

Deklaratat e mëposhtme janë në favor të riadhesimit të migrantëve ilegalë	Deklaratat e mëposhtme janë në favor të integritit të migrantëve ilegalë
Nëse keni ardhur në Europë ilegalisht, nuk mund të qëndroni legalisht. Është çështje ligji dhe rendi.	Njerëzit vijnë për shkak të varfërisë dhe dëshpërimit. Edhe nëse Europa nuk mund t'i mbajë të gjithë, ata që tanimë kanë shkuar duhet t'i integrojë.
Migrantët ilegalë punojnë në një ekonomi ilegale dhe nuk paguajnë taksat, pra janë një barrë për sistemin e sigurimit social dhe të shtetit.	Po t'u jepen migrantëve ilegalë dokumente të rregullta, ata do të mund të punojnë legalisht, do të paguajnë taksat, gjë që është e mirë për të gjithë.
Migrantët ilegalë ka të gjatë t'i kthehen krimit si rrugëdalje për të mbijetuar.	Duke mos rregulluar situatën e migrantëve, ata shtyhen drejt kriminalitetit. Rregullimi i statusit të tyre do të ulte nivelin e krimit midis migrantëve ilegalë.
Europa tashmë ka shumë të huaj. Europeanët nuk mund presin të tjerë sepse ndryshe ata nuk do të kenë asnjëherë në kontroll papunësinë.	Europeanët i ndiejnë që tani efektet e punës të pakualifikuar në vendet e tyre, që vetëm do të përkeqësohet më shumë në vitet që vijnë, ndërsa popullsia plakët. Europa ka nevojë për punëtorë të rinj. Por vetëm migrantët që jetojnë në të legalisht mund të kualifikohen si duhet dhe t'u japin fëmijëve të tyre një edukim të mirë.

7. E ardhmja e Europës

Qëllimi i këtij kapitulli është të diskutojmë për të ardhmen e Bashkimit European. Studentët tuaj mund të vijnë me propozime të tyre mbi të ardhmen e integritit European.

U kërkoni studentëve tuaj të krahasojnë rezultatet e tyre me ato të shokëve të klasës dhe bëni, për shembull, një listë të kërkesave të tyre politike.

Kriza që filloi më 2008 çoi në një numër reformash në Europë, sidomos në sektorët financiarë dhe bankat. Ajo nxiti gjithashtu një diskutim të rëndësishëm lidhur me të ardhmen e Bashkimit European, si në shtetet anëtare ashtu edhe në nivel European. Diskutimet u shtuan, ndër të tjera, nga raportet dhe fjalimet e presidentëve të institucioneve të ndryshme Europiane. Përdorni materialin e broshurës për të diskutuar mbi Europën që studentët do të donin të shihnin në të ardhmen. A duhet të bëhet Bashkimi European diçka si një lloj shteti federal European? Apo ata mendojnë se vendi i tyre duhet të shkëputet lidhjet me BE-në? Mos duhet të ruhet status quo-ja?

Për informacion të mëtejshëm shih sa më poshtë:

‘Përse na duhet tani një “Shtetet e Bashkuara të Europës” — fjala e zëvendës presidentes të Komisionit European, Viviane Reding në Universitetin Passau:

http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-12-796_en.htm

‘Një model për një bashkim të thellë dhe të vërtetë ekonomik dhe monetar’. — Komisioni European — Nëntor 2012

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0777:FIN:EN:PDF>

‘Drejt një bashkimi të vërtetë ekonomik dhe monetar’ — Raporti Herman Van Rompuy, President i Këshillit European — Dhjetor 2012:

http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/134069.pdf

Në këtë ushtrim nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara.

Qëllimi nuk është që studentët të vijnë me propozimet e tyre përfundimtare, por më tepër që ata të bëhen të ndërgjegjshëm për çështjet dhe të kuptojnë që BE-ja nuk është një produkt i përfunduar, por një punë në progres që mund dhe duhet të strukturohet dhe zhvillohet me vendimet politike të qytetarëve të saj.

Situata aktuale është si vijon:

Numri: Ka mendime të ndryshme për këtë. Kur u shkrua kjo (Korrik 2013), BE-ja kishte 28 shtetet anëtare pas pranimit të Kroacisë. Negociatat e pranimit me Malin e Zi dhe Serbinë tanimë kanë filluar. BE-ja zhvillon negociatat edhe me dy vende (Islandën dhe Turqinë) dhe ka deklaruar si kandidate ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria dhe Bosnjë Hercegovina) kanë marrë një siguri të përgjithshme se do të jenë në gjendje të pranohen kur të plotësojnë kriteret. Logjikisht e njëjta gjë ndodh edhe me Kosovën, e cila shpalli pavarësinë në Shkurt 2008, por nuk është njohur nga të gjithë shtetet anëtare.

Kompetencat: Duhet të bëhet dallimi midis kompetencave të jashtëzakonshme të BE-së (rregullat doganore për kufijtë e jashtëm), zonat e përbashkëta të kompetencave (politika e transportit), që BE-ja ndan me shtetet anëtare dhe kompetencat që mbeten me shtetet anëtare (organizimi i sistemeve të arsimit). Duhet theksuar se BE-ja nuk mund të vendosë thjesht, të marrë më shumë kompetenca. Më tepër vetë shtetet anëtare mund t'ia japin këto BE-së. Me fjalë të tjera fuqinë për të dhënë kompetenca e kanë shtetet anëtare.

Aspekti ushtarak: Në bazë të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, BE-ja zhvillon komponentin ushtarak dhe tashmë ka realizuar grupet e saj të betejave. Ajo punon ngushtësisht me NATO-n dhe përdor infrastrukturën e saj. Kjo është përcaktuar në marrëveshjen midis BE-së dhe NATO-s (Marrëveshja Berlin Plus).

Vendimmarrja: Shumica e akteve ligjore (direktivat dhe rregulloret) janë miratuar bashkërisht nga Parlamenti European dhe Këshilli i

Ministrave. Pjesa më e mirë e përjashtimeve nga ky rregull u hodhën poshtë nga Traktati i Lisbonës. Megjithatë politika e jashtme mbetet në dorë të shteteve anëtare. BE-ja luan një rol diplomatik në kontekstin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP) dhe të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes (CSDP).

Procedura e votimit: Traktati përcakton cilat çështje vendosen me shumicë votash dhe cilat vendosen unanimisht. Traktati i Lisbonës ka shtuar numrin e fushave ku shumica e votave është e mjaftueshme.

'Shumica' arrihet me rreth 70% të votave të siguruar (shumicë e kualifikuar), që përbën shumicën e shteteve anëtarë dhe në të njëjtën kohë, të paktën 62% të popullsisë së BE-së. Traktati i Lisbonës futi konceptin e 'dyfishit të shumicës'. Kjo do të thotë se një vendim kërkon shumicën e shteteve anëtarë (në fakt 55%) dhe një shumicë të popullsisë (në fakt 65%). Megjithatë, këto rregulla nuk do të hynë në fuqi deri më 2014. Disa rregullime tranzitore do të mbeten deri më 2017.

Euro: Euro-ja ka jo vetëm një funksion ekonomik, por edhe (dhe ndoshta para së gjithash) një funksion politik: për të mbajtur Bashkimin e zgjeruar European të bashkuar. Gjatë viteve të fundit është bërë e qartë se një bashkim i monedhës mund të funksionojë vetëm në qoftë se shoqërohet nga një bashkim politik. Domethënia e kësaj është e diskutueshme dhe është një problem debati intensiv midis shteteve anëtare dhe më gjerë.

Monedha e vetme e bën të pamundur për shtetet pjesëmarrës të kompensojnë dobësinë e tyre me mjete shvlerësimi. Nëse disa vende të zonës Euro nuk u përmbahen marrëveshjeve të bëra së bashku, më në fund u takon të tjerëve të bëhen garant për ta ose t'u falin borxhet. Prandaj BE-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit që t'i japë zonës së Euros një karakter më detyrues: Mekanizmi i Stabilitetit European (EMS), përdorimi i të cilit varet nga disa kushte të reformës ekonomike, dhe Kontrata Fiskale që i detyron shtetet anëtare të shkurtojnë borxhet e tyre, janë shfaqje të kësaj politike. Humbja e sovranitetit kombëtar duhet të vlerësohet përkundrejt faktit që shtetet anëtare pjesëmarrëse përdorin një monedhë botërore që jep stabilitet. Brenda zonës së Euros kostot dhe risqet e shkëmbimeve nuk luajnë rol, gjë që e bën eksportin më të lehtë.

Çmimet krahasuese e bëjnë më të lehtë për klientin të porositë mallra në vende të tjera, duke siguruar një vlerë më të mirë për paranë. Kjo është diçka e rëndësishme, veçanërisht në epokën e internetit. Megjithatë, masat për të shpëtuar Euro-n kanë çuar në tensione midis dhe brenda disa shteteve anëtare, për shkak të politikave të rrepta shtrënguese që janë zbatuar.

Vendet e punës: Ndonëse shkurtime në buxhet janë të domosdoshme për të ulur deficitet, duket qartë se kriza e sotme nuk zgjidhet nëse shtetet anëtare nuk mbeten konkurruese dhe më mirë akoma nuk bëhen më konkurruese. Është shumë e rëndësishme që në BE të ulet papunësia për arsye ekonomike, por edhe sociale dhe të politikës së brendshme. Eurobarometri tregon qartë se, për shumë Europeanë papunësia është çështja më e rëndësishme. Rreth gjysma e të pyeturve janë të shqetësuar se mund të humbin vendin e punës ose se nuk do të jenë në gjendje të gjejnë shpejt një punë tjetër. Shumë qytetarë po ndjejnë peshën e krizës financiare dhe ekonomike. Shumica e të pyeturve mendojnë se Bashkimi European është e vetmja shpresë për të luftuar krizën (Eurobarometer Nr.78) dhe shpresojnë se do të merren masat e nevojshme. Fondet e BE-së do të përdoren akoma më shumë në këtë drejtim në periudhën e re financiare 2014 deri më 2020.

Strategjia Europa 2020 kërkon rrugë të ndryshme për krijimin e vendeve të punës. Për shembull, tregu i vetëm duhet të zhvillohet më tej dhe pengesat për tregtinë të hiqen, në mënyrë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, veçanërisht të kenë më shumë mundësi në këtë treg për të përkrahur sipërmarrjen. Përveç kësaj, investimet e planifikuara, kryesisht nga Fondi European i Zhvillimit Rajonal, Fondi Social European dhe Fondi i Kohezionit, të ndihmojnë për krijimin e vendeve të reja të punës. BE-ja shpreson gjithashtu se zgjerimi i tregtisë ndërkombëtare do të ndikojë pozitivisht në tregun European të punës.

Brenda një kohe të shkurtër migrimi brenda BE-së, që është rritur vitet e fundit, mund të zbutë disa nga efektet e këtyre problemeve, por ai nuk mund të zëvendësojë një politikë aktive të tregut të punës.

* Ushtrim shtesë — 'Këndi i folësve'

f. 52

Një detyrë e mundshme shtesë për studentët mund të ishte paraqitja e mendimeve të tyre në formën e 'Këndit të Folësve'.

Ushtrimi i sugjeruar: U flisni studentëve për të famshmin 'Kënd të Folësve' në Hyde Park në Londër, ku kushdo mund të ngrihet lirish dhe t'i thotë turmës çfarë të dojë. Pse të mos bëjnë studentët një kënd të tillë për zgjedhjet Europiane? U thoni atyre të shprehin mendimet e tyre në formën e një fjalimi, sa më të shkurtër e të këndshëm.

Mbase e bëjnë këtë në një nga gjuhët e huaja që mësojnë në shkollë. Ç'mendon audienca? Janë njerëzit dakord? Nëse jo, do ta mendojnë edhe një herë?

